


RAPORTI TEKNIK
I
PROJEKTIT TË PROPOZUAR.



Subjekti Fizik "ILIR SULA"

Prodhim tuba betoni.

Ilir Sula

Sula

LOERMA sh.p.k.

Ekspert Mjedisi i Licensuar

Mars 2022



Sfond.

Subjektit Fizik, Ilir Sula, subjekt me NIPT L42907205S, është rregjistruar në QKB në 07.05.2014, me fushë të veprimtarisë : **“Prodhim tuba betoni, gjeosondë (punime për puse)”**.

Vëndi i ushtrimit të aktivitetit është në adresën: Elbasan, Cërrik, Lagjja Nr.3, Rruga Rinia, objekt një katësh me Nr. Pasurije 323/21, zona kadastrale 2281.

Subjekti ushtron aktivitetin e prodhimit të tubove prej betoni si dhe të tregtimit të tyre. Ujin e nevojshëm teknologjik e merr nga një pus i hapur/shpuar në teritorin e subjektit, pronë e tij.

Ky raport teknik, pregatitet me kërkesën e drejtuesit të këtij subjekti z. Ilia Sula dhe, ka për qëllim të trajtojë dy aktivitete, atë të prodhimit të tubave prej betoni si dhe të shfrytëzimit të pusit të ujit të hapur në teritorin nën pronësinë e vetë subjektit.

Raporti i paraqitur në vijim synon të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin në mjedisin e zonës ku punohet dhe më gjërë rreth saj, të projektit të propozuar për zbatimin në:

- Përdorimin e tokës dhe ndikimet në të,
- Ndikimet në florën dhe faunën,
- Ndikimet në ujrat sipërfaqësore dhe ato nëntoksore, burimet e ujit, etj.
- Ndikimet në ajër nga shkarkimet e gazeve të ndryshëm dhe të pluhurit.
- Ndikime në infrastrukturën e zonës.
- Ndotjen akustike.
- Çdo ndikim social-ekonomik të mundshëm.

Pjesë e rëndësishme e këtij raporti është parashikimin dhe përshkrimi i masave zbutese të ndikimeve të identifikuar dhe analizuar të projektit të paraqitur, me qëllim eliminimin ose/apo zvogëlimin e efekteve negative në mjedis nga shkarkimet e identifikuar me synim përmisimin e cilësisë dhe të qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet :

- ❖ Shqyrtimit të alternativave të ndryshme të zbatueshme brenda fushës së veprimtarisë së projektit të paraqitur.
- ❖ Analizës së faktorëve pozitivë dhe të atyre negative me ndikim në mjedis, duke dhënë rekomandimet përkatëse, zbatimin e të cilave bën të mundur reduktimin ose/apo eliminimin e këtyre ndikimeve negative.

Grupi i ekspertëve hartues të këtij raporti kryen mbikqyrjen e terrenit në të gjithë zonën ku zbatohet projekti i paraqitur, duke vlerësuar zbatueshmërinë e tij. Ato kryen vërtetime të ndryshme edhe ndaj treguesve mjedisorë përfshi këtu edhe të biodiversitetit të zonës.

Ato zgjedhën dhe zbatuan metodën e listë–kontrollit, e cila vendos nga njera anë të gjithë burimet e mundshme të ndikimeve negative në mjedis dhe nga ana tjetër, bartësit e këtyre ndikimeve si dhe parashikimin e madhësisë së çdo njerit prej ndikimeve të identifikuar.

Pjesë e këtij raporti është përshkrimi i statusit aktual të territorit, korniza ligjore e tij, mjedisi biofizik, gjeologjia dhe hidrogeologjia e rajonit etj.

Ekspertët kanë patur parasysh dy tipare të rëndësishëm të impaktit mjedisor:

- a. Shterimin e burimeve.
- b. Ndotje e mbjedisit apo cënimin e treguesve mjedisor të zonës ku zbatohet projekti.

Vlerësimi i ekspertëve përkatës është se kemi të bëjmë me zbatim përgjithësisht korrekt të projekteve të ndërtimit, projekteve të instalimit të linjave teknologjike dhe rrjeteve inxhinjrike, duke treguar një menaxhim të qëndrueshëm të kësaj veprimtarije. Me zhvillim të qëndrueshëm duhet të kuptojmë kontrollin e ndotjes, përdorimin eficient të energjive të përdorura, menaxhimin e mbetjeve teknologjike, parandalimin e aksidenteve mjedisore dhe të atyre në punën e shfrytëzimit të linjës së prodhimit të betoneve etj.

I. Instalimi dhe aktivitetet e tij.

Subjektit Fizik, ILIR SULA, për një periudhë kohe relativisht të gjatë ushtron aktivitetin në veprimtarinë e prodhimit të tubave prej betoni. Linja teknologjike e prodhimit të betonit është vënë në shfrytëzim në zbatim të projekteve përkatëse në të cilët janë përcaktuar të gjitha detajet e shfrytëzimit, duke filluar nga lloji i lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse që përdoren për prodhimin e betoneve, të sheshet e punës, numurin e fuqisë puntore, kohën e punës, ditët e punës në muaj dhe në vit në përputhje me kapacitete prodhuese mujore e vjetore.

- a. Vendndodhja e veprimtarisë.

Vendndodhja e linjës teknologjike të prodhimit të tubave prej betoni, pasqyrohet në planvendosjen, bashkangjitur këtij raporti dhe, bën pjesë në planshetën i përfshirë brenda Hartës K-34-101-(240-D).



Koordinatat e katër pikave të kontureve kufizuese të këtij trualli janë pasqyruara mëposhtë:

X1 = 45 44 382.590 X2 = 45 44 398.326 X3 = 45 44 299.093 X4 = 45 44 283.937

Y1 = 44 14 545.564 Y2 = 44 14 565.347 Y3 = 44 14 647.104 Y4 = 44 14 625.647

Brenda këtyre koordinatave përfshihet një sipërfaqe prej 5939.8 m².

Trualli mbi të cilën zhvillohet kjo veprimtari nuk ka asnjë lloj funksioni apo përdorimi veç atij në shërbim të kësaj veprimtarije. Ai karakterizohet nga një sipërfaqe pothuajse e çveshur nga bimësia. Në të, nuk ka asnjë element infrastrukture, kjo edhe për faktin se është larg qendrës së banuar, mungesës së burimeve ujore, është jashtë planeve të pushtetit për ndërtimin e infrastrukturës dhe elementëve të saj.

Objekti gjendet rreth 100 metra larg nga rruga kombëtare Cërrik – Belësh ose Cërrik - Papër. Kjo rrugë u shërben edhe banorëve të zonës për lëvizjen e tyre si dhe të produkteve bujqësore. Në afërsi të këtij objekti nuk gjenden godina banimi apo të shërbimeve tregtare, shkolla etj.

Në përfundim të objektit në një distancë ajrore prej rreth 150 metra gjendet një pikë/stacion i magazinimit dhe tregtimit me pakicë të karburanteve.

b. Proçeset kryesore teknologjike të kësaj veprimtarije.

Veprimtarija e Subjektit Fizik, "ILIR SULA" konsiston në zhvillimin e aktivitetit të prodhimit të tubave prej betoni të përmasave të ndryshme.

Si pjesë e saj është edhe shfrytëzimi i pusit të ujit i hapur në teritorin e vetë subjektit.

b.1 Prodhimi i tubave të betonit.

Projekti i propozuar ka të bëjë me prodhimin dhe tregtimin e tubave prej betoni kryesisht me përmasa $\varnothing = 0.300$ m dhe gjatësi 1.0 m.

Subjekti ka bërë investime të rëndësishme, në sistemimin e truallin duke e përshtatur atë për prodhimet që kryen si dhe në blerjen dhe instalimin e pajisjeve me tregues teknik dhe teknologjikë, që japim prodhime në sasi dhe tregues cilësor të kënaqshëm. Prodhimi kryesor i kësaj veprimtarije janë tubot prej betonit të dimensioneve të ndryshme.

Proçesin teknologjik në këtë veprimtari, zhvillohet duke kaluar në tre faza të rëndësishme që kanë të bëjnë me:

- i. Sigurimin në kohën e duhur dhe me tregues cilësor të pranueshëm të lëndëve të para, rërë, granil dhe çimento.
- ii. Zbatimin me korrektesë të parametrave teknik, gjatë prodhimit të betonit dhe të tubove të përmasave të kërkuara në treg.
- iii. Mbajtjen në gadishmëri të plotë teknike të pajisjeve dhe makinerive të instaluar për realizimin e prodhimeve të kërkuara.

Në tërësi aktiviteti zhvillohet në ambiente të përshtatëshme për operacionet e punës që zhvillohen në to si dhe duke mos krijuar dëme apo efekte negative të ndryshme në mjedisin ku zhvillohen dhe rreth tij.



Proçesi teknologjik, fillon me përgatitjen e sasisë së betonit të përcaktuar edhe në markën përkatëse. Vijon me prodhimin e elementëve të caktuar dhe përfundon me tharjen natyrale të këtij prodhimi.

Hapsira punuese është e organizuar në këtë mënyrë:

- ❖ Sheshi për depozitimin e llojeve të ndryshme të inerteve;
- ❖ Venddepozitimi i çimentos;
- ❖ Impianti i prodhimit të betonit dhe produkteve të betonit;
- ❖ Sheshi për tharjen dhe për reklamimin e produkteve të realizuara;
- ❖ Mjediset ku kryhen shërbimet teknike ndaj formave metalike që përdoren për derdhjen e tubave;
- ❖ Mjediset e zyrave dhe ato higjienosanitare;
- ❖ Rrugë dhe sheshe për qarkullimin dhe parkimin e mjeteve të transportit.

Inertet blihen nga subjekte të licencuar për prodhimin dhe transportin e tyre. Ato vendosen në qiell të hapur, në anën e djathtë të sheshit të punës. Kryesisht janë rëra të lara si dhe granil me madhësi të kokrrizësh maksimalisht deri në 1 cm.

Në krah të tyre, në një ambjent të mbrojtur nga reshjet e shirave sistemohen të vendosur mbi paleta druri thasët e çimentos.

Impianti i prodhimit të betonit dhe produkteve të betonit është prodhim italian, i cili punon pothuajse në mënyrë të automatizuar në pregatitjen e betoneve si dhe në mbushjen e formave të prodhimit të elementëve prej betoni, kryesisht të tubave. Ngarkimi i inerteve në përzjerësin e betonit, bëhet me anë të transportjerit me rryp gome. Punëtori, ngarkon një karrocë dore me inerte dhe i hedh ato në bunkerin metalik, në krye të transportjerit prej gome, që gjendet në kuotën zero, në nivelin e trualli. Në vijim, ai bën ngarkimin e sasisë së duhur të çimentos dhe të ujit dhe, mbikqyr punën përzjerësit/prodhuesit të betonit.

Betonieria, bën homogjenizimin e të gjithë lëndëve të para të hedhura në të sipas recepturës dhe markes së kërkuar për prodhimin e produkteve.

Kjo makineri, ka këto pajisje kryesore:

- ❖ Hinkën metalike të ngarkimit të inerteve dhe të çimentos;
- ❖ Transportjerin me rryp gome me gjërësi 0.600 m dhe lartësi 1.70 m;
- ❖ Linjat e marrjes së ujit dhe të komandimit të sasisë së tij, që duhet për të pregatit betonin;
- ❖ Hinkën metalike të zbrazjes së betonit të prodhuar.
- ❖ Pultin e kontrollit dhe të komandimit.

Pas përzjerjes dhe uniformizimit të masës së betonit, prej disa minutash, betoni i pregatitur nëpërmjet hinkës metalike të shkarkimit të tij, kalon/hidhet në formët metalike të vendosur mbi një platform vibruese.

Gjatë kohës që mbushet forma, platforma mbi të cilën ajo është vendosur vibron vertikalisht dhe horizontalisht, me një frekuencë të përcaktuar. Me anë të këtij vibrimi, sigurohet shpërndarja dhe njëkohësisht ngjeshja e masës së betonit që futet në formën metalike.

Eksperienca e gjatë e punës së punëtorit, bën që të mos kemi mangësi të betonit për mbushjen e formës dhe/ose tepricë të betonit të prodhuar.

Pas mbushjes së plotë të formës, ajo çvendoset nga platforma mbushëse, me anë të një autovinçi pirun, në një vend të përcaktuar, në sheshin e depozitimit të produktit të gatshëm. Kur vlerësohet se betoni brenda formës ka ngurtësuar plotësisht, bëhet çmontimi i formës metalike (heqja e saj) dhe tubi prej betoni lihet në gjendje të lirë.

Forma metalike shkon në sektorin e kontrollit teknik, ku pastrohet dhe riparohet nëse një gjë e tillë kërkohet. Pas kësaj ajo është e gatshme për t'u përdorur përsëri.

Elementët/objektet e formuar që dalin nga impjanti i pregatitjes së tyre, merren me anë të vinxhit tip pirun, me kapacitet deri 2000 kg, dhe vendosen në hapsirën përkatëse të sheshit përkatës, të objektit, ku lihen deri në mpiksjen/tharjen e tyre të plotë.

Ngarkimi dhe transporti i brendëshëm në këtë veprimtari janë dy prej proceseve teknologjike kryesore. Këtyre dy proceseve ju nënshtrohen të gjitha llojet e lëndëve/materialeve të cilat

përdoren si lëndë e parë të tilla si inertet, çimentoja etj. dhe njëkohësisht edhe prodhimet e kësaj veprimtarije si tubat prej betoni etj.

Lëndët e para sillen në objekt kryesisht me mjete transporti, të subjekteve të liçensuar për prodhimin dhe transportin e inerteve, çimentos etj.

Transporti i tubave të betonit nga linja e prodhimit në vendin e reklamimit dhe të tregtimit të tyre kryhet me anë të vinxhit tip pirun, me kapacitet deri 2000 kg. Ky mjet bën edhe ngarkimin e automjeteve të cilët bëjnë transportin e tubave të betonit, nga ky subjekt në subjektet që i përdorin ato.

Brenda teritorit të objektit gjendet edhe një shesh i sistemuar i cili shërben për parkimin e mjeteve që punojnë në këtë veprimtari.

Linja teknologjike e prodhimit të tubave të betonit, vihet në punë sa herë që ka kërkesa për prodhime të tilla. Kjo linjë punon vetëm gjatë paradites nga ora 8⁰⁰ deri në 16⁰⁰ Eksperienca e punës në shfrytëzimin e saj ka treguar se, lina ka punuar maksimalisht gjatë 180 ditëve dhe ka arritur të prodhojë rreth m³ beton ose mijë tuba betoni gjatë një viti kalendarik.

b.2. Shfrytëzimi i pusit të ujit.

Subjekti Fizik zotëron një sondë për hapjen/çpimin e puseve të madhësive të ndryshme. Ai e ka të rregjistruar këtë veprimtari në QKB (Shih ekstraktin bashkangjitur). Për plotësimin e kërkesave të aktivitetit të prodhimit të betonit, subjekti ka hapur një pus uji në teritorin e tij, me përmasa :

- Thellësia 15 m;
- Diametri 0.800m.

Trupi i pusit është tërësisht i betonuar, dhe kjo veshje betoni del rreth 1.0 m mbi sipërfaqen e tokës.

Është instaluar një elektropompë uji në hapsirën e brendëshme të pusit, dhe nëpërmjet një sistemi tubacionesh uji shpërndahet në të gjitha pikat konsumatore të tij, si në pajisen e përgatitjes së betonit, ambjentet hidro-sanitare, pajisjet për njomjen me ujë të prodhimeve dhe të shesheve e rrugëve të brendëshme. Uji i pusit nuk përdoret për konsum human nga punonjësit e këtij subjekti.

II. Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi.

2.1. Lëndët e para.

Në vijim po përshkruajmë disa prej lëndëve të para që përdoren aktualisht apo/dhe mund të përdoren në të ardhmen.

- *Agregati / mbushësit (rëra me zhavorrin ose çakalli),*

Agregati është komponenti më i përfaqësuar në masën e përgjithshme të betonit (70-80%). Sipas vetive fizike dhe kimike të tij ai nuk është material inert për arsye se ka ndikim në vetitë fiziko-kimike të betonit. Për përgatitjen e betonit shfrytëzohet agregat me prejardhje të ndryshme – natyrore dhe artificiale, siç janë:

- **Agregat natyror** (rërë, çakall dhe grimca / kokrra).

Agregati natyror – rërë dhe çakall nxirret nga shtretërit e lumenjve dhe përrrenjve afër brigjeve të tyre. Kokrrat e këtij agregati natyror janë kryesisht të rrumbullakuara si pasojë e transportit më shpesh bashkë me ujin dhe erozionit, që ndikon në mënyrë të volitshme në përpunueshmërinë dhe vendosshmërinë e betonit.

- **Agregat i grimcuar ose i bluar**, i fituar me grimcim të shkëmbinjve gëlqeror monolit ose të palidhur.

Agregati i grimcuar, fitohet me grimcimin e shkëmbinjve natyror të fortë prej cilësdo prejardhje. Kokrrat e agregatit të grimcuar janë me tehet të mprehta çka mundëson inkastrim të tyre më të mirë dhe kjo kontribuon për përmirësimin e disa karakteristikave mekanike të betonit. Vetë e volitshme e agregatit të grimcuar është edhe homogjeniteti petrografik i tij çka kontribuon që t'i shmangët ose zvogëlohet konçentrimi i sforcimeve në beton nga veprimi i ngarkesave ose ndryshimeve të temperaturave.



rërë, çakall dhe grimca / kokrra



agregat i grimcuar i shkëmbinjve gëlqeror

- **Agregat artificial** i fituar nga materiale të mbetura të ndryshme dhe prodhime –anësore industriale (mbeturina nga hiri i teceve, skorjet metalurgjike, materiale vullkanike etj.);
- **Agregate speciale**, siç janë: kermaziti, perliti i ekspanduar, materiale me fije të ndryshme etj.

Mes vetive fizike-mekanike më të rëndësishme ndaj të cilave duhet të kemi kujdes për çdo njerin prej llojeve të agregatit janë:

- Forma dhe pamja e sipërfaqes të kokrrizës së agregatit,
- Përmbajtja e grimcave të imëta në agregat,
- Përmbajtja e grimcave të lehta në agregat,
- Mbështjellja e sipërfaqes të kokrrave të agregatit,
- Përmbajtja e materieve organike në agregat,
- Prania e silicit amorf në agregat,
- Masa vëllimore e agregatit,
- Qëndrueshmëria e agregatit,
- Përbërja granulometrike e agregatit etj

Për arsye se për përgatitjen e betonit më shpesh shfrytëzohen kokrra kompakte, lagështinë e agregatit në masë më të madhe e përbën uji, i cila mbahet/gjendet në sipërfaqen e kokrrave. Lagështia sipërfaqësore, në varësi nga sipërfaqja specifike e agregatit mund të lëvizë deri 10 %. Lagështia e agregatit duhet të përcaktohet para përdorimit të tij, për shkak të përcaktimit të sasisë të ujit që duhet t'i shtohet gjatë përgatitjes së betonit.

○ *Lëndët lidhëse.*

Lëndët lidhëse kanë për detyrë t'i lidhin pjesët nga agregati në një komponent të tërësishëm. Si mjet lidhës mund të shfrytëzohen të gjitha llojet e çimentos, gëlqeres ndërtimore, gipsit, asfaltit, lloje të ndryshme të polimerive e tjera.

Çimentoja është mjet lidhës hidraulik i cili në kombinim me ujin transformohet në brumë të çimentos, i cili me kalimin e kohës ngurtësohet. Në varësi nga përbërja dhe mënyra e përpunimit ekzistojnë më shumë lloje të çimentos, por më së tepërmi përdoret i ashtuquajtur **portland-çimento**.

Çimentot grupohen në klasa të cilat shënohen me numrat 25, 35S, 35B, 45S, 45B dhe 55 ku janë:

- S – çimento me rritje më të ngadalësuar të qëndrueshmërisë.
- B – çimento me rritje më të shpejtë të qëndrueshmërisë.

Me përzierjen e portland-çimentos dhe ujit fitohet brumë prej çimentos–pastë e cila gradualisht fillon të lidhet dhe ngurtësohet gjatë një periudhe kohe të caktuar, çka e ndryshon gjendjen e vetë agregate, duke kaluar nga një lëndë plastike në lëndë të ngurtë. Shkaqet për ndodhjen e këtyre ndryshime janë proceset shumë të ndërlikuara fizike – kimike që zhvillohen në marëdhënien e çimentos me ujin, e njohur si **hidratim të çimentos**.

Proçesi i hidratimit fillon disa minuta pas përzierjes të çimentos dhe ujit dhe në etapën e parë e cila zgjatë rreth 5 deri 10 orë, brumi i çimentos gradualisht ngurtësohet – lidhet dhe pastaj krijohet ngurtësimi gradual. Studime të ndryshme teorike dhe praktike kanë treguar se për

hidratimin e tërësishëm të çimentos është i nevojshëm sasi e saktë ujit, përcaktuar në vartësi nga lloji dhe përbërja e çimentos.

Shpejtësia e hidratimit varet nga një numër i madh i faktorëve, të tillë si:

- përbërja minerale e çimentos,
- cilësia e bluarjes të çimentos,
- sasia e ujit,
- temperatura e rrethinës/ambientit rrethues,

○ *Uji.*

Uji në formën e tij të pastër, është lëng pa shije dhe pa erë po ashtu dhe pa ngjyrë. Duket i pangjyrë në sasi të vogla për syrin tonë, megjithëkëtë mund të shihet si i kaltër në sasi të mëdha ose me vegla shkencore. Uji është lëngu më i përhapur në toke. Formula kimike e tij është H_2O . Uji është në ekuilibër dinamik midis gjendjes së gaztë dhe asaj të lëngët në temperaturë dhe trysni standarde. Uji në vetvete është pa shije dhe pa ngjyrë por në kontakt të gjatë me ajrin lidhet me dioksidin e karbonit (CO_2) dhe merr një shije të athët acidi karbonik që nuk është i mirë për shëndetin. Ai është i domosdoshëm për të gjitha format e jetës dhe njihet edhe si tretësi më i gjithanshëm. Pa të, jeta siç e njohim ne, do të ishte e pamundur.

Uji është një tretës shumë i mirë dhe tret shumë lloje substancash. Ndryshe mund të quhet tretës universal. Substancat që treten mirë në ujë quhen hidrofiliqe ndërsa, ato që nuk treten mirë në ujë, quhet hidrofobike. Uji është tretësi më i mirë (universal) falë strukturës së molekulës së tij që është dipolare.

Uji i përshtatshëm për t'u pirë nga njeriu quhet ujë i pijshëm. Uji që nuk është i përshtatshëm për t'u pirë, por që nuk është i rrezikshëm për njerëzit quhet ujë i sigurt.

○ *Shtesa speciale - aditivë.*

Aditivët paraqesin shtesa të veçanta me të cilat mund të përmirësohen disa veti të betonit të freskët dhe të ngurtësuar siç janë përpunueshmëria, vendosshmëria-shtruarja e betonit, pa depërtueshmëria e ujit etj.



Pusi i ujit.



Gabina elektrike.

2.2 Energjitë.

➤ Energjia elektrike.

Objekti është lidhur me rrjetin e furnizimit me energji elektrike të qytetit të Cërrikut, duke vendosur një gabinë e transformator ajror me fuqi 350 kW, kapacite i mjaftueshëm për një punë normale të pajisjeve që subjekti ka instaluar.

Vendosja e gabinës dhe lidhja me rrjetin përkatës të kësaj zone të banuar, është bërë nga specialistët përkatës të operatorit rajonal të shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe në bazë të kontratës së hartuar mes dy palëve.

Në këtë veprimtari kemi një konsum të energjisë elektrike prej rreth kWh/muaj.

➤ Uji.

Uji që i nevojitet si lëndë ndihmëse në prodhimin e betoneve merret nga një pus i hapur brenda pronës së investitorit. Në pus është instaluar një elektropompë e lidhur me një rrjet shpërndarës të ujit në të gjitha pikat ku ai konsumohet

Uji i pijshëm, merret nga rrjeti i furnizimit me ujë të qytetit. Edhe për marrjen e tij është bërë një kontratë me subjektin që administron ujësjellësin e fshatit. Uji i pijshëm përdoret vetëm për nevojat humane. Furnizimi me ujë është mesatarisht rreth 5 m³/muaj.

➤ Karburante (naftë & benzinë).

Nafta dhe benzina shërben për punën e mjeteve të transportit të brendëshëm dhe të atij jashtë subjektit. Konsumi i karburatit nga këto mjeteve rezulton në një vlerë mesatare prej 300 litra në muaj.

3. Burimet e shkarkimeve nga instalimi.

Zhvillimi për një kohë relativisht të gjatë i aktivitetit të prodhimit të tubave prej betoni, ka bërë të mundur identifikimin e disa ndikimeve negative në zonën e zhvillimit të kësaj veprimtarie prodhuese si dhe në afërsi të saj.

3.1. Shkarkime të pluhurave dhe të gazeve.

Zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të betonit dhe elementëve ndërtimor prej betoni, shoqërohet me shkarkime në ajër të gazeve dhe pluhurit.

Burimi i shkarkimit të këtyre gazeve është puna e mjeteve ngritëse e transportuese, si rezultat i djegies lëndë së lëndës djegëse naftë ose benzinë.

Në përbërje të gazeve që shkarkohen janë: bioksidi i squfurit (SO₂), monoksid i karbonit (CO), gazi karbonik (CO₂), oksid i azotit dhe komponime të tjera të tij (NO_x), përbërës të tjerë të avullueshëm etj.

Krahas shkarkimit të gazeve, kemi edhe shkarkim të pluhurit gjatë zhvillimit të proceseve të shkarkimit të inerteve, çimentos etj. por edhe prej lëvizjes së mjeteve ngritëse e transportuese të materialeve brenda teritorit ku zhvillohet kjo veprimtari.

3.2. Shkarkime të mbetje e ngurta teknologjike.

Zhvillimi i procesit teknologjik të prodhimit të tubave prej betoni nuk shoqërohet me krijim të mbetjeve teknologjike të ngurta. Këtu krijohen mbetje të ngurta të cilat përmbajnë kryesisht letër të thasëve të çimentos, ambalazhe plastike dhe qelqi si dhe mbetje ushqimore të punonjësve. Të gjitha këto lloj mbetjesh, hidhen në kazanët e mbetjeve urbane të zonës së banuar dhe largohen që andej me mjetet e subjektit të kontraktuar nga Bashkia Cërrik.

3.3. Shkarkime të mbetjet e lëngëshme.

Nga zhillimi i këtij procesi prodhimi, nuk krijohen shkarkime të ujrave teknologjike. Gjithsesi kemi shkarkime të ujrave sipërfaqore gjatë reshjeve të shiut si dhe shkarkime të rastësishme të ujrave gjatë proceseve të ndryshme pune. Këto ujra mbartin me vete ngrimca të ngurta të inerteve si dhe çimento. Ujrat derdhen në kanalin anësor të rrugës automobilistike dhe më tej në përroin e fshatit i cili rrjedh disa metra larg kufirit perëndimor të objektit.

Ujrata e zeza derdhen në një gropë septike dhe largohen që andej në periudha kohe të caktuara. Në këtë zonë të banuar nuk ka rrjet kanalizimesh për shkarkimin e ujrave

3.4. Shkarkime të zhurmave.

Gjatë punës së pajisjes për prodhimin e betonit dhe të mbushjes së formave me beton si dhe të makinave ngirtëse dhe transportuese, në ambjentet e punës janë të pranishme zhurma, intensiteti i të cilave nuk pengon në zhvillimin e bisedave normale.

4. Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes.

Objekti ku zhvillohet kjo veprimtari, gjendet në perëndim të qytetit të Cërrikut, në teritorin që administrohet nga Bashkia Cërrik. Është një zonë me një numur të kufizuar shtëpiash banimi por, me një numur të vlersueshëm subjektsh tregtare dhe prodhues. Zona mund të kategorizohet tërësisht me zhvillim bujqësor, në të cilën kultivohen përgjithësisht bimët e arave, perimet dhe drurët frutorë.

Bashkia Cërrik kufizohet në very me Bashkinë Elbasan dhe Peqin, në jug-lindje me bashkinë Gramsh, në jug me Bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me Bashkinë Belësh. Kryeqendra e kësaj bashkie është qyteti i Cërrikut.

Teritori që administron kjo bashki, shtrihet përgjithësisht në një zonë fushore dhe kodrinore, në mes të shtretërve të dy lumenjve, Shkumbin dhe Devoll. Ky teritor zë një sipërfaqe prej 189.65 km² dhe në të jeton një popullsi prej 46650 banorësh, rreth 189 banor/km².

Trualli mbi të cilën zhvillohet kjo veprimtari është pothuajse i rrethuar nga toka bujqësore. Ai gjendet në anë të djathtë të rrugës automobilistike Cërrik – Belësh, rreth 100 m larg saj duke kaluar nëpërmjet një rruge të zonës.

Pejsazhi dhe ndërtimi topografik i rajonit ku zhvillohet kjo veprimtari është ai i një zone të banuar rurale, në të cilën mbizotërojnë banesat publike një deri dy katëshe të rrethuara me oborre të gjelbëruara dhe toka të mbjella me kultura të ndryshme bujqësore.

Rajoni përfshihet në zonën e klimës mesdhetare, me dimër të shkurtër e të butë dhe me verë të nxehtë e shumë të thatë. Temperatura **mesatare** e ajrit varion nga 7 °C në Janar deri në 24 °C në Korrik.

Erërat që fryjnë nga Veri – Lindja janë dominuese gjatë gjithë vitit dhe vlerën maksimale e arrijnë në dimër me 4,7 m/sek. Në pranverë çfaqet drejtimi i dytë dominues i erërave, Jug – Perëndim në 11,9 % të vitit.

Përsa i përket rreshjeve, pjesa më e madhe e tyre bie në periudhën e ftohtë të vitit dhe më pak në periudhën e ngrohtë për shkak të aktivitetit ciklonik. Gjatë periudhës së ftohtë të vitit bie 65 % e shumës vjetore të reshjeve dhe gjatë periudhës së ngrohtë 34 %. Shuma vjetore e reshjeve është 1145 mm, ndërsa maksimumi 24 orë i reshjeve është 135 mm.

Ushtrimi i aktivitetit që ne vlerësojmë si dhe, të gjitha zhvillimet e tjera të programuara që lidhen me këto aktivitete, nuk prekin zona të mbrojtura me ligj si, rezervat kombëtare natyrore, parqet kombëtare, zonat e mbrojtura, zonat me rendësi arkeologjike, turistike, etj.

Raportit mbi gjendjen e mjedisit në Shqipëri për vitin 2020, i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Agjensisë Kombëtare të Mjedisit Tiranë, nuk e përfshin këtë zonë/rajon të Qarkut Elbasan.

5. Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritëshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis.

Eksperienca disa vjeçare e shfrytëzimit të linjës teknologjike të prodhimit të betonit dhe të elementëve ndërtimor prej betoni, ka treguar se kemi shkarkime të përkohëshme në ajër, gjenerim të zhurmave si dhe menaxhimit të mbetjeve të ngurta apo sterile.

5.1. Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritëshme, në mjedis.

a. Shkarkime në ajër.

Në ambjentet e punës së kësaj veprimtarije ndodhin shkarkime në ajër të gazeve dhe pluhurave për aq kohë sa zhvillohen :

- Proçeset e ngarkimit/shkarkimit të inerteve e çimentos.
- Lëvizjet e mjeteve ngritëse dhe transportuese të lëndëve/materialeve të ndryshme.

Gazet që shkarkohen kanë në përbërje të tyre bioksid të squfurit (SO₂), monoksid karboni (CO), gaz karbonik (CO₂), oksid të azotit dhe komponime të tjera të tij (NO_x), përbërës të tjerë të avullueshëm etj.

Burimi i shkarkimit të këtyre gazeve është puna e motorëve të mjeteve ngritëse e transportuese që punojnë me lëndë djegëse kryesisht me naftë.

Krahas shkarkimit të gazeve, kemi edhe shkarkim të pluhurit gjatë zhvillimit të proceseve të ngarkimi të inerteve, çimentos, mbetjeve dhe lëvizjes së mjeteve transportuese.

b. Gjenerimi i zhurmave.

Gjenerimi i zhurmave është gjithashtu një dukuri e përkohëshme e cila është e pranishme gjatë kohës së punës së mjeteve motorrike që punojnë në këtë objekt si dhe e punës së linjës së prodhimit të betonit. Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë kohës së punës së këtyre mjeteve janë të niveleve 66 – 78 LeqdB (A).

c. Shkarkim i ujrave të ndotur.

Nga zhillimi i këtij procesi prodhimi, nuk krijohen shkarkime të ujrave teknologjike. Gjithsesi kemi shkarkime të ujrave sipërfaqësore gjatë reshjeve të shiut si dhe shkarkime të rastësishme të ujrave gjatë proceseve të ndryshme pune. Këto ujra mbartin me vete ngrimca të ngurta të inerteve si dhe çimento. Ujrat derdhen në kanal inesor të rrugës automobilistike..

Ujrata e zeza derdhen në një gropë septike dhe largohen që andej në periudha kohe të caktuara. Në këtë zonë të banuar nuk ka rrjet kanalizimesh për shkarkimin e ujrave

d. Shkarkime në tokë.

Zhvillimi i procesit teknologjik të prodhimit të tubave prej betoni nuk shoqërohet me krijim të mbetjeve teknologjike të ngurta. Këtu krijohen mbetje të ngurta të cilat përmbajnë kryesisht letër të thasëve të çimentos, ambalazhe plastike dhe qelqi si dhe mbetje ushqimore të punonjësve. Të gjitha këto lloj mbetjesh, hidhen në kazanët e mbetjeve urbane të zonës së banuar dhe largohen që andej me mjetet e subjektit të kontraktuar nga Bashkia Cërrik.

e. Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet projekti.

Aktiviteti i prodhimit të betonit dhe elementëve prej betoni prej disa vitesh, ka prekur tashmë pejzazhin dhe topografinë e kësaj zone.

Dëmtimi i vegjetacionit bimor ka ndosur gjatë hapjes së punimeve për ndërtimin e objektit dhe të instalimit të pajisjeve teknologjike.

Zbatimi i programe të rehabilitimitin trualit të objektit dhe në afërsi të tij, gjelbërimin me bimë e pemë që rriten në këtë zonë, gjatë shfrytëzimit dhe në mbyllje të aktivitetit, do të përmirësojë dukshëm pejzazhin dhe topografinë e zonës.

f. Ndikimet negative në habitatet dhe biodiversitetin e zonës ku zhvillohet projekti.

Nga zhvillimi i këtij aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e cila është përcaktuar në V.K.M-në Nr. 804. dt. 04.12.2003

Zona që shfrytëzohet nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për "Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme" për t'u shpallur "Peizazh i mbrojtur".

g. Ndikime sociale nga zhvillimi i projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe burimeve të tjera natyrore si dhe, shqetësime që mund të lindin nga ndikimet në mjedis për shkak të shkarkimeve të ndryshme, zhurmave, rënies së zjarreve etj.

Aktiviteti i prodhimit të tubave prej betoni, kryet larg zonave të banuara, në perëndim të qytetit të Cërrikut.

Zbatimi i këtij projektit gjatë këtyre viteve nuk ka kërkuar çvendosje apo ndryshime të tjera të zonave të banuara në afërsi të tij apo/ose, krijimin e zonave të reja banimi. Ky aktivitet bëhet në një zonë tepër të kufizuar në krahasim me sipërfaqen dhe popullsinë e Bashkisë Cërrik. Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka kërkuar dhe nuk do të kërkojë përdorimin e tokës shtesë veç asaj që është për shfrytëzim.

Zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të tubave prej betoni nuk shoqërohet me aksidente mjedisore të cilat mund të sjellin pasoja të dëmshme në treguesit cilësor të mjedisit të vendit ku ponohet dhe në afërsi të tij si:

- ndotje të ujërave nga lëndë të rrezikshme,
- emetime në ajër të gazeve helmuese
- kontaminim të tokës.

5.2. Karakteristikat e ndikimeve negative dhe efektet e rëndësishme të tyre në mjedis.

a. Vlerësimi i ndikimeve.

Proçesi i vlerësimit të ndikimeve negative në mjediset e vendeve të punës dhe në zonën rreth tyre, është i lidhur me kryerjen e një sërë njohjesh dhe vlerësimesh të tilla si:

- Njohja e vlerave natyrore dhe mjedisore të zonës si dhe të truallit/tokës që shfrytëzohet.
- Njohja me infrastrukturën inxhinjrike egzistuese dhe me nevojën për plotësim të saj me infrastrukturë të re në plotësim të kërkesave që parashtron projekti që zbatohet.
- Njohja me lëndët e para dhe ato ndihmëse si dhe me energjitë e nevojshme që përdoren për zbatimin e projektit.

Mbështetur mbi këto të dhëna bazë si dhe, në treguesit mjedisor të subjektit të dalë gjatë punës disa vjeçare të tij, ekspertë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për të përcaktuar vlerësimeve të identifikuar. Vlerësimi i kryer ka të bëjë me efektet e tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta në treguesit cilësor të mjedisit, në zonën ku zhvillohet projekti dhe është një nga fazat më të rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse:

- Tregon llojin, elementët dhe kohë zgjatjen e çdo lloji ndikimi të identifikuar.

- Përafron ato me objektivitet me tërësinë e bashkëveprimeve të tyre me parametrat mjedisor të zonës ku zhvillohet projekti.

Kriteret e përdorur për vlerësimin e ndikimeve variojnë dhe përcaktohen nga faktorë të përcaktuar dhe, rezultatet e arritura drejtohen kryesisht ndaj përmirësimeve më të mundshme të vlerave të mjedisit të ndikuar.

b. Shtrirja fizike e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson sipërfaqen apo dimensionet hapsinore të shtrirjes së një ndikimi të përcaktuar e vlerësuar në raport me burimin që gjeneron këtë ndikim. Duke vlerësuar llojet e elementëve ndotës të shkarkuar në mjediset e vendeve të punës, sasi të respektive të tyre si dhe drejtimin e erërave, gjykojmë se kemi të bëjmë me një shtrirje të kufizuar të përhapjes së tyre.

c. Kohëzgjatja e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson periudhën kohore se sa mund të zgjasë një ndikim i caktuar në dimensionin kohor dhe kështu mund të kemi ndikim të përhershëm/mbetës apo ndikim të përkoshëm.

Pothuajse të gjithë ndikimet e tjera negative në mjedis si psh shkarkimi i gazeve, zhurmave etj. janë ndikime të përkoshëme. Gjenerimi i elementëve ndotës në mjediset e vendeve të punës, ndërpritet sapo ndërpritet apo ndalon puna e pajisjeve e makinerive që i gjenerojnë ato. Një tjetër element i përkohshmërisë është edhe, zhvillimi i kësaj veprimtarije vetëm në një periudhë 8 orë në ditë, zakonisht paradite dhe, ndërpreja e saj në ditët e pushimeve zyrtare përfshi këtu të shtunat e të djelat.

d. Kthyeshmëria

Ky parametër vlerëson të gjitha mundësitë e kthimit të mjedisit të ndikuar, në gjendjen e tij të mëparëshme apo/ose aftësitë për rehabilitimin dhe regjenerimin e plotë të mjedisit të ndikuar.

e. Rëndësia.

Ky parametër realizon një vlerësim total të të gjithë përmasave të mësipërm dhe njëkohësisht thekson e rekomandon drejtimit më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe zbatuar nga drejtuesit e subjektit, për të administruar saktësisht çdo lloj ndikimi të identifikuar.

f. Llojet e ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jodirekte).

Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të betonit janë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis.

6. Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme.

Prodhimi i tubave prej betoni, është një praktikë e njohur dhe e zbatuar gjërësisht në vendin tonë. Po kështu duhet pranuar se, egziston një numur relativisht i madh njerëzish të cilët kanë njohuritë e duhura teorike dhe praktike në këtë fushë, duke përfshirë këtu personelin inxhinjer dhe atë teknik por edhe punonjës të punës së drejtpërdrejtë në këtë sektor.

Kjo njohje dhe eksperiencë është një bazë e rëndësishme jo vetëm për të njohur dhe vlerësuar ndikimet e mundëshme në mjedis por, çka është më e rëndësishmja, për të përcaktuar ndërhyrjet e duhura teknike dhe administrative në minimizimin apo eliminimin e ndikimeve negative në mjedisin ku zbatohet projekti.

Ndikimet e identifikuara gjatë shfrytëzimit të linjës teknologjike të prodhimit të tubave prej betoni, përgjithësisht nuk kanë shtrirje të madhe fizike, për shkak të pozicionit gjeografik të objektit që shfrytëzohet, trëndafililit të erërve në këtë zonë, llojit dhe sasisë së elementëve ndotës së mjedisit, përkohshëmrisë së gjenerimit të ndotësve etj.

Duke vlerësuar eksperiencë e drejtuesve teknik të kësaj veprimtarije, në vijimi do të paraqesim disa rekomandime, zbatimi në praktikën e përditëshme të punës, do bëjë të mundur **parandalimin dhe minimizimin deri në maksimumtë të ndikimeve negative në mjedis.**

- Duhet të kontrollohen dhe mirëmbahen vazhdimisht makineritë dhe pajisjet e linjës teknologjike të prodhimit të tubave prej betoni me qëllim që të parandalohen difektet në to si dhe derdhjet e pakontrolluara të inerteve e çimentos.
- Duhet të kontrollohen dhe mirëmbahen vazhdimisht kanalet e hapura për disiplinimin e ujrave të rreshjeve të shiut me qëllim parandalimin e ndotjen e ujrave nga deluvioneve.
- Lëvizja e mjeteve brenda objektit duhet të bëhet vetëm në rrugët e përcaktuara brenda saj.
- Në stinën e thatë të vitit mund të përdorim uji për lagjen e rrugëve dhe shesheve të brendëshme të objektit.
- Të gjitha mjetet do të kontrollohen periodikisht në pikat e kontrollit të specializuara dhe të liçesuara. Eliminimi i difekteve të mundëshme të rastit duhet të bëhet në vendin e caktuar brenda objektit.
- Furnizimi i mjeteve me karburat duhet të kryhet në pikën më të afërt të karburantit.
- Transporti i produktit nga objekti në drejtim të subjekteve që e përdorin atë duhet të bëhet me mjete të përshtatëshme e të mbulura me mushama.
- Mbetjet urbane të krijuara gjatë kësaj veprimtarije duhet të sistemohen në një vend të përcaktuar brenda saj dhe të largohen në mënyrë periodike në vendet e përcaktuara nga Bashkia Cërrik.

Në tabelën në vijim, pasqyrohen, llojet e ndikimeve të identifikuara, burimi apo shkak i tyre, pasojat e drejtpërdrejta në mjedis, kohëzgjatja e ndikimit si dhe ndërhyrjet e mundëshme për parandalimin apo zvogëlimin e ndikimit në mjedis.

Nr.	Ndikimi i mundëshëm	Burimi/shkaku i zhvillimit	Pasojat në mjedis.	Kohëzgjatja e ndikimit.	Ndërhyrjet e mundëshme për parandalimin apo zbutjen e ndikimit.
1	Ndikime në tokë.				
	Derdhja e pakontrollua të inerteve dhe çimentos	Ndodhja dhe difekte të papritura në pajisjet e linjës teknologjike.	Ndryshojnë parametrat dhe pamja fizike e truallit.	Mbetëse ose/apo të përherëshme.	Sistemimi i inerteve dhe çimentos në vendin e caktuar brenda teritorit të objektit dhe, rifutja e tyre në përdorim.
	Derdhja e pakontrolluar e karburantit dhe vajrave nga mjetet e punës.	Ndodhja e difekte të papritura në mjetet e punës ose/apo kryerja e veprimeve jokorrekte të furnizimit të mjetit me karburant dhe vaj, në ambientin ku ai punon.	Ndotje e truallit duke ndikuar në trguesit cilësor të tij.	Ndotje e përkohëshme e cila rehabilitohet duke ndërhyrë menjëherë në pastrimin e truallit të ndotur.	Të bëhet kontroll teknik si dhe kryerja e shërbimeve të nevojshme periodike të mjeteve në vende të përcaktuara.
2	Ndikime në ajër.				
	Shkarkimi i gazeve nga mjetet ngritëse dhe transportuese.	Gaze që dalin gjatë djegies së naftës, nga motorrët e mjeteve.	Ndotja e ajrit në zonën ku punojnë këto mjete.	Ndotje e përkohëshme e cila, ndalon sapo ndalon puna e këtyre mjeteve.	Të mos punojnë mjete me problem teknike. Të përdoren lëndë djegëse me tregues cilësor brenda standarteve përkatëse.
	Shkarkim i pluhurave.	Pluhuri shoqëron kryesisht proceset e shkarkimit të inerteve dhe çimentos si dhe të lëvizjes së mjeteve ngritëse e transportuese.	Ndotja e ajrit në zonën e kësaj veprimtarije.	Ndotje e përkohëshme e cila, ndërpritet sapo përfundojnë proceset që gjenerojnë pluhurin.	Në raste të përcaktuara të përdoret procesi i lagies me ujë. Mjetet të lëvizin në rrugët e përcaktuara.
	Emetimi i zhurmave.	Zhurmat gjenerohen nga puna e makinerive që punojnë në këtë objekt.	Ndotje akustike e zonës ku punohet dhe më gjërë.	Ndotje e përkohëshme e cila ndërpritet sapo ndalojnë punën makineritë që e gjenerojnë zhurmën.	Mjete që emetojnë zhurma duhet të jenë në gjendje teknike normale.

7. Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur.

Disa prej përparësive të zgjedhjes së këtij trualli po i pasqyrojmë në vijim:

- Është pronë private e subjektit.
- Gjendet në një zonë me infrastrukturë inxhinjerie të plotësuar.
- Është e lidhur organikisht me rrjetin rrugor kombëtar.
- Gjenden lehtësisht persona të arsimuar dhe kualifikuar për të kryer proceset e punës, të programuar nga kjo veprimtari.

Lidhur me instalimin e teknologjisë së përdorur duhet të themi se është një teknologji e njohur dhe e zbatuar në shumë veprimtari të tilla.

Zbatimi në praktikë i proceseve teknologjike të përcaktuar në projektet përkatëse, kërkon një numur relativisht të kufizuar makinerish e pajisjes. Janë mjete standarte të cilat janë lehtësisht të manovrueshme dhe që mirëmbahen pa shumë probleme.

Pajisjet e instaluara si dhe parametrat teknologjikë me të cilët punojnë këto pajisje, besojmë se janë bashkëkohore, nisur nga fakti që ato vijnë nga vende të BE-së.

8. Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme).

Betoni i markave të përcaktuar prodhohet në impjantin e prodhimit të tij, në sasi të përcaktuara. E gjithë sasi e betonit të prodhuar shkon drejtpërdrejt në makinerinë e mbushjes së formave metalike, për prodhimin e tubave prej betoni. Në këtë makineri qëndron vetëm një forme metalike, dhe e gjithë sasia e betonit të prodhuar shkon për mbushjen e saj. Nuk ka raste të tepicës apo të mungesës së betonit të prodhuar, sepse në të dy rastet do të kemi sasi relativisht të mëdha betoni jashtë përdorimit dhe rritje të konsiderueshme të shpenzimeve të prodhimit.

Eksperienca gati 10 vjeçare e aktivitetit prodhues në këtë subjekt dëshmon se nuk kemi mbetje teknologjike të betonit të prodhuar apo të tubave të papërdorëshme.

Mbetjet urbane, largohen çdo ditë dhe vendosen në vend depozitimin e mbetjeve urbane të përcaktuar nga Bashkia Çërrik, pa asnjë lloj përpunimi.

9. Masat për përdorimin efiçent të energjisë.

Veprimtaria e prodhimit të tubave prej betoni, kërkon përdorimin e energjisë elektrike si dhe të energjisë që fitohet nga djegia e naftës.

Energjia elektrike përdoret për vënien në punë të pajisjeve të linjës së prodhimit të betonit dhe të tubave prej betoni, në ndriçimin e ambjenteve të punës, zyrave, rrugëve të brendëshme etj. Shfrytëzimi i linjës teknologjike të prodhimit të tubave prej betoni bëhet jo në mënyrë të vazhdueshme i diktuar nga kërkesat e tregut. Kjo bën që të punohet në ditë të caktuara dhe kryesisht gjatë orëve të ditës. Pajisjet konsumatore të rrymës elektrike janë të tipit standart dhe

lehtësisht të kontrollueshme për regjimin normal të punës së tyre duke garantuar një koefiçent të lartë të përdorimit të rrymës elektrike. Këto pajisje vihen në punë dhe ndalojnë sipas një programi të komanduar nga paneli përkatës.

Lënda djegëse e tipit diezel/naftë përdoret për punën e mjeteve ngritëse dhe mjete të transportit. Puna e këtyre mjeteve është periodike dhe e kondicionuar nga kapacitetet e prodhimit të kërkuar. Mirëmbajtja e vazhdueshme teknike e këtyre mjeteve është kusht thelbësor për konsum brenda standarte teknike të lëndës djegëse gjatë punës së tyre.

10. Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:

10.1. Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Aksidentet në pjesën më të madhe të tyre, ndodhin për shkak të mos zbatimit korrek të rregullave të vënies në punë dhe të ndalimit të makinerive e pajisjeve. Në shumicën e rasteve kemi të bëjmë kryesisht me shkaqe subjektive, të krijuara nga vetë punonjësit. Në këtë subjekt, egziston një eksperiencë e mirë, në trajtimin e aksidenteve dhe kjo dëshmohet në numurin mjaft të kufizuar të ndodhjes së tyre gjatë kësaj periudhe relativisht të gjatë pune.

Këtu gjenden rregulloret të shfrytëzimit të linjave teknologjike, të rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë, të mbrojtjes nga zjarri si dhe të trajtimit të emergjencave të ndryshme.

Punonjësit instruktohen për njohjen e kërkesave teknike të projektit që zbatohet për shfrytëzimin e karrierës dhe krahas saj edhe për kryerjen e çdo operacioni pune pa rrezik të dëmtimit të shëndetit të tyre apo siç njihet zakonisht për rregullat e sigurimit teknik e të mbrojtjes në punë.

Ky instruktim bëhet mbështetur në rregulloret përkatëse të hartuara e të miratura, pjesë të veçanta të të cilave janë të vendosura në vende të dukëshme brenda teritorit të objektit.

Për të bërë të mundur dhënien e menjëherëshme të ndihmës së shpejtë në rastet e aksidenteve të mundëshme në një ambient të veçantë mbahet kutia e ndihmës së shpejtë.

Parandaalimi i aksidenteve bëhet edhe duke zbatuar me korrektësi :

- Kryerjen e kontrolleve periodike mbi gjendjen teknikike të pajisjeve e makinerive si dhe kryerjen e riparimit të difekteve të ndodhura.
- Kontrollin periodik të rrjetit të tokëzimeve si dhe të pajisjeve mbrojtëse të rrjeteve elektrike e pajisjeve komanduse të impjanteve
- Kontrollin periodik të pajisjeve për fikjen e zjarreve të mundëshme si fikset e dorës dhe hidranteve të ujit.

10.2. Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Egziston një përvojë pozitive në ndërprerjet e përkohëshme të aktivitetit prodhues në linjën teknologjike, të prodhimit të tubave prej betonit. Këto ndërprerje janë të detyruara përgjithësisht për mungesë të tregjeve të produkteve të prodhuara këtu. Ndërprerjet zgjasin edhe disa javë/muaj.

Edhe në veprimtarinë e tij normaale, këtu punohet vetëm paradite, nga ora 8⁰⁰ deri në ora 16⁰⁰, nga e hëna në të shtunë. Kështu kemi ndërprerje periodike të aktivitetit, për çdo ditë si dhe në ditët e pushimeve dhe të festive zyrtare.

Mbyllja përfundimtare e aktivitetit ka kërkesa më rigorozë të cilat kërkojnë gjithashtu procedurë të përcaktuara saktësisht, për çdo stad zhvillimi të proceseve që duhen kryer për mbylljen e aktivitetit. Kështuqë, kërkohen studime të plota nga grupe inxhinjerësh apo ekspertësh të fushave të ndryshme, të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit finciar, mjedisor, të administrimit të teritorit, të efekteve sociale etj.

Krahas kryerjes së këtyre studimeve, duhet të përgatitet dokumentacioni përkatës për marrjen e lejeve të nevojshme, si psh vendi ku do hidhen mbeturinat që krijohen, metalike, plastike gome, druri, vajrash, inertesh etj.

Çdo të bëhet me truallin pas lirit të tij, do të vijojë të qëndrojë si një truall për përdorim industrial apo do përshtatet për veprimtari të tjera !?

Linja e prodhimit të betonit ka kërkesa teknike relativisht më të vogla. Në këtë linjë përpunohen kryesisht inerte, çimento dhe ujë.

Çimentoja kërkon evadim të shpejtë sepse qëndrimi prej një kohe relativisht të gjatë pa e përdorur influencon në përkeqsimin e treguesve cilësor të saj.

Inertet përgjithësisht nuk pësojnë ndryshime të ndjeshme fiziko-kimike.

Makineritë dhe pajisjet mund të shiten për t'u ripërdorur nga subjekte të tjera nëse vijojnë të jenë në gjendje teknike të mira ose shiten për skrap.

Konstruksioni metalik i çatisë së bashku me mbulesën shiten për skrap.

Organet përkatëse duhet të kenë dhënë lejet për vendin ku do të vendosen këto mbeturina të ngurta, inertesh.

11. Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.

Në V.K.M. Nr. 435, datë 12.09.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë", veprimtaria të cilën ne vlerësojmë nuk ka klasifikim të drejtpërdrejtë për proceset teknologjike që zhvillohen në këtë subjekt;

V.K.M Nr.177, datë 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse.", në asnjë prej Anekseve dhe kapitujve të saj nuk ka përcaktime për të katër proceset teknologjike që zhvillohen në këtë veprimtari.

VKM Nr. 1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit.”

Kapitulli II. Hartimi dhe miratimi i programit kombëtar të monitorimit të mjedisit, pika 8. Personat fizikë dhe juridikë, të cilët pajisen me leje mjedisore për ushtrimin e një veprimtarije, hartojnë programe monitorimi të treguesve mjedisorë të trysnisë, si dhe dokumentojnë të dhënat përkatëse, sipas modeleve të përgatitura nga Agjensia e Mjedisit dhe të miratuara nga Ministri.

Kapitulli III. Zbatimi i programit kombëtar të monitorimit të mjedisit.....

Pika 7. Monitorimi i treguesve të dukurive natyrore e të cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe të biodiversitetit kryhet nga institucione monitoruese të specializuara, duke lidhur kontrata, në bazë të procedurave të konkurimit, që vlerësojnë profilin e sejcilit, përvojën dhe kualifikimin e stafit, pajisjet e aparaturat që disponon, si dhe projektin e tij për monitorimin të paraqitur për konkurim.

Pika 8. Personat fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve janë subjekt i lejes mjedisore, monitorojnë treguesit mjedisorë, sipas pikave Ç1, Ç2,Ç5,Ç6,Ç7 dhe Ç8, në nivel industrial.

Kapitulli IV. Dorëzimi dhe përpunimi i të dhënave të monitorimit....

Pika 1 gërma c. Të dhënat e monitorimit, të dorëzuara nga personat fizikë dhe juridikë ,në ARM. Të dhënat dorëzohen sipas afate të përcaktuara në urdhërin e ministrit, në çdo kohë, për aksidentet industriale, si dhe kur u kërkohet zyrtarisht nga ARM për nevoja urgjente të qarkut, ku ato veprojnë. Të dhënat përcillen në agjensi në përputhje me formatin e kërkesës së bërë prej saj.

Ne vlerësojmë mjaft të rëndësishme plotësimin e detyrimeve ligjore të sipërcituara, nga drejtuesit ligjor të këtij subjekti. Dhe, krahas tyre, të gjitha përcaktimet që do t’i vihen në lejën e mjedisit.

Në tabelën në vijim, pasqyrohen llojet e elementëve që duhen monitoruar, periodiciteti i kryerjes së këtyre monitorimeve si dhe personi përgjegjës, i subjektit, që duhet të ndjekë zbatimin e këtij detyrimi ligjor.

NR.	ELEMENTI QË MONITOROHET	PERIODICITETI	ANALIZA	PËRGJEGJËSIA LIGJORE
1	Përmbajtja e grimcave të ngruta (PM10) në ajrin e zonave të punës, gjatë punës : <ul style="list-style-type: none"> • së linjës së prodhimit të betonit; • Rrugët dhe sheshet e qarkullimit të mjeteve të transportit. 	Çdo 6/ 12 muaj	Përmbajtja e grimcave të ngruta (PM10)	Drejtuesi ligjor i subjektit.
2	Monitorim i ujrave që shkarkohen nga instalimi.	Çdo 6 / 12 muaj	Përmbajtja e grimcave të ngruta. pH, etj.	Drejtuesi ligjor i subjektit.
3	Monitorim i gjenerimit të zhurmave në punë.	Çdo 6/ 12 muaj	Intensiteti dB(A) dhe përhapja e tyre	Drejtuesi ligjor i subjektit.

12. Plani i menaxhimit të mbetjeve.

Proçeset teknologjike të zhvilluara në këtë aktivitet, nuk shoqërohen me gjenerimin e mbetjeve teknologjike të rrezikëshme apo jo. Këtu krijohen kryesisht mbetje të ngurta urbane.

Mbetjet urbane të krijuara gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarije përbëhen kryesisht nga:

- Ambalazhe të letrës e kartonit.
- Ambalazhe prej plastike e qelqi.
- Mbetje drunore e metalike
- Mbetje ushqimore etj.

Këto mbetje mblidhen në kazanë metalikë të vendosur në vende të caktuara brenda teritorit të objektit dhe largohen prej tyre në mënyrë periodike duke u dërguar në kazanët e mbetjeve urbane të vendosur nga Bashkia Cerrik.

-FUND-